

DITA BOTËRORE E UJIT

22 MARS

Dita Botërore e Ujit e cila organizohet çdo vit ne 22 Mars ka si qëllim të rrisë vëmendjen mbi

rëndësinë që ka uji. Tema për këtë vit “Natyra për Ujin”, eksploron Zgjidhjet e Bazuara në

Natyrë (ZBN) për sfidat me ujin me të cilat ne përballemi në shekullin e 21. Dëmtimi i mjedisit,

së bashku me ndryshimet klimaterike po nxitin krizat që lidhen me ujërat të cilat ne i shohim në

mbarë botën. Përmbytjet, thatësitat dhe ndotja e ujit janë bërë gjithnjë e më keq nga vegjetacioni

i degraduar, toka, lumenjtë dhe liqenet. Kur ne i lëmë pas dore ekosistemet tona, ne e bëjmë më

të vështirë furnizimin e të gjithëve me ujin që u nevojitet për të mbijetuar.

Fushata për këtë ditë botëore është “Përgjigjia është tek natyra” dhe synon të rrisë ndërgjegjësimin lidhur me ZBN. Zgjidhjet e Bazuara në Natyrë kanë mundësinë për të zgjidhur

shumë nga sfidat tona me ujin. Ne duhet të bëjmë shumë më shumë me infrastrukturën “e gjelbër” dhe aty ku është e mundur ta harmonizojmë atë me infrastrukturën “gri”.

Mesazhi kryesor është që ZBN, të tilla si mbjellja e pemëve për të rigjallëruar pyjet, lidhja e

lumenjve me zonat e përmbytura, dhe rivendosja e ligatinave, është një mënyrë e qëndrueshme

dhe kosto efektive për të ndihmuar në ribalancimin e ciklit të ujit, zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimaterike si dhe përmirësimin e shëndetit të njeriut dhe mënyrës së jetesës.

Përmes përdorimit të ZBN për të ndihmuar në përmbushjen e nevojave për ujë të një popullatë në

rritje, ne do të kontribuojmë në krijimin e një ekonomie në formë rrethi, si dhe në të njëjtën kohë

do të ndihmojmë në mbrojtjen e mjedisit natyror dhe zvogëlimin e ndotjes – të dy këto qëllime

kryesore në Objektivin 6 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, objektiv i cili angazhon

botën për sigurimin e disponueshmërisë dhe menaxhimin e qëndrueshmërisë së ujit dhe të kanalizimeve për të gjithë në vitin 2030.

Fakte kyçe

Nevoja për ujë.

2.1 miliardë njerëz kanë mungesë aksesit në shërbime të sigurta që menaxhojnë ujin e pijshëm.

Në 2050 sipas një vlerësimi, numri i popullsisë do të rritet në 2 miliardë njerëz dhe kërkesa botërore për ujë të pijshëm mund të rritet 30% më e lartë se sot.

Buqësia përdor aktualisht 70% të sasisë globale të ujit për vaditje, një shifër e lartë për popullsinë e dendur. Industria merr 20% të totalit, të dominuar nga energjia dhe prodhimet. Pjesa e mbetur prej 10% shkon për përdorim shtëpiak dhe më pak se 1% përdoret për ujë të pijshëm.

Disponueshmëria e ujit:

Sot rreth 1.9 miliardë njerëz jetonë në zona me pak ujë. Deri në vitin 2050, kjo shifër mund të rritet rreth 3 miliardë njerëz.

Cilësia e ujit:

Sipas një vlerësimi rreth 1.8 miliardë njerëz përdorin një burim të ujit të pijshëm të pa përmirësuar si dhe pa mbrojtje ndaj ndotjeve prej ujërave të zeza.

Globalisht, mbi 80% e ujërave të zeza të krijuara nga shoqëria rrjedhin në mjedis pa u trajtuar.

Klima dhe mjedisi

Vlerësimet tregojnë se numri i njerëzve të rrezikuar nga përmblytjet, është parashikuar të

rritet nga 1.2 miliardë që është sot në rreth 1.6 miliardë në 2050, që përbën gati 20% të popullsisë së botës.

Sot, rreth 1.8 miliardë njerëz preken nga degradimi dhe shkretëtimi i tokës. Të paktën 65% e tokës së pyllëzuar është në një gjendje të degraduar.

Rreth 64- 71% e ligatinave natyrore kanë qenë humbur si rezultat i aktivitetit njerëzor që nga viti 1900.

Erozioni i tokës buqësore merr me vete 25 në 40 miliard ton të sipërfaqes së punueshme

çdo vit, duke reduktuar ndjeshëm rendimentin e prodhimeve dhe aftësia e tokës për të rregulluar nivelin e ujit, karbonit dhe të lëndëve ushqyese . Mbeturinat, që përmbajnë sasi të mëdha të azotit dhe fosforit, po ashtu janë një kontribues i madh për ndotjen e ujit.

Cilat janë zgjidhjet e bazuara në natyrë?

Rigjallërimi i pyjeve, kullotave dhe lagunat natyrore, rilidhja e lumenjve në zonat e përmblytura,

krijimi i mbrojtëseve përgjatë rrjedhës së ujit, janë disa nga shembujt e zgjidhjeve të bazuara në

natyrë (ZBN) të cilat ndihmojnë në menaxhimin e cilësisë dhe të disponueshmërisë së ujit.

ZBN nuk janë zgjidhja për të gjitha sfidat me të cilat ne përballemi në lidhje me ujin si pasojë e rritjes së popullsisë në botë, por ato mund të ofrojnë mundësi të reja të cilat janë dhe kosto efektive për plotësimin e infrastrukturës së pamjaftueshme apo të dëmtuar (amortizuar).
Për

shëmbull:

Disponueshmëria dhe furnizimi me ujë: Grumbullimi i ujit nëpërmjet rrugëve natyrore, lagështisë së tokës/grumbullimi i ujërave nëntokësore, mund të jenë më të qëndrueshme dhe kosto efektive sesa ngritja e infrastrukturave të tilla si digat.

Cilësia e ujit: ndotja nga bujqësia mund të reduktohet në mënyrë të dukshme nga ZBN si

bujqësia mbrojtëse e cila ruan tokën nga erozioni ose mbrojtëset bregore, shiritat e tokës përgjatë rrjedhës së ujit të cilat janë të mbjella me pemë dhe shkurre.

Menaxhimi i rrezikut: Efektet që kanë sjellë ndryshimet klimaterike si përmbytjet ekstreme të shpeshta, mund të zbuten me anë të disa zgjidhjeve të bazuara në natyrë të tilla si krijimi i disa mbrojtëseve riparuese ose lidhja e lumenjve me zonat e përmbytura. Aplikimi i disa zgjidhjeve të bazuara në natyrë krijon atë që njihet si “infrastruktura e gjelbër”

sisteme natyrore ose gjysëm natyrore, të cilat na japin përfitime të njëjta ose të ngjashme me ato

që merren me mënyrën tradicionale të “infrastrukturës gri” që ndërtohet nga njeriu.

Zgjidhjet e bazuara në natyrë si dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Zgjidhjet e bazuara në natyrë për menaxhimin e cilësisë dhe furnizimit me ujë, mbështesin

arritjen e të gjithë qëllimeve të Objektivit 6 të OZHQ: sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimi i qëndrueshmërisë së ujit dhe të kanalizimeve për të gjithë.

Gjithashtu zgjidhjet e bazuara në natyrë mund të luajnë rol në të tjera OZHQ:

Objektiv 1: Jo varfëri, Objektiv 2: Zero uri, Objektiv 3: Shëndet i mirë: Punë të reja shpesh janë krijuar nga ZBN dhe përmirësimi i shëndetit nga një cilësi më e mirë e ujit do të thotë produktivitet më i lartë.

Objektiv 7: Energjia e pastër dhe e përballueshme, Objektiv 9: Industria, inovacioni dhe infrastruktura, Objektiv 11: Qytete dhe komunitete të qëndrueshme, Objektiv 12: Prodhim dhe konsumim i përgjegjshëm: ZBN kërkojnë pak ose aspak energji. Ato gjithashtu ndihmojnë në sigurimin e më shumë burimeve të qëndrueshme të ujit për ti shërbyer vendbanimeve në rritje.

Objektiv 14: Jeta nën ujë, Objektiv 15: Jeta në tokë: Ligatinat mund të reduktojnë ndotjen nëpërmjet filtrimit dhe të rrisin biodiversitetin përmes zgjerimit të habitateve natyrore

“NATYRA PËR UJIN

PËRGJIGJIA ËSHTË TEK NATYRA”